NANSEN DIALOGUE CENTRE
SKOPJE

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

QENDRA PËR DIALOG NANSEN SHKUP

Rr. Bahar Mois nr.4 1000 Skopje
Tel.: +389 (0) 2 3209 905
www.ndc.org.mk

QENDRA PËR DIALOG NANSEN SHKUP

Raport vjetor
për vitin 2020

20 VITE PUNË TË SHKËLQYER NË PAJTIM,
NDËRTIM TË PAQES DHE ARSIM NDËRKULTUROR

www.ndc.org.mk

VETON ZEKOLLI
Drejtor Ekzekutiv
Qendra për Dialog Nansen Shkup

Të shkruash një retrospektivë për vitin 2020, një vit që u shënua kryesisht nga pandemia globale dhe nga shumë pengesa, kufizime dhe protokolle mbrojtëse, turbullon fokusin, arritjet dhe suksesin. Edhe përkundër të gjitha këtyre vështirësive, Qendra për Dialog Nansen shënoi një vit të suksesshëm gjatë të cilit ne implementuam përbërësit kryesorë të planit vjetor, filluam projekte të reja dhe nënshkruam marrëveshje bashkëpunimi me partnerë strategjikë dhe afatgjatë.

Në mars të vitit 2020, QDN Shkup nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me trupin koordinues për zbatimin e strategjisë kombëtare "Një shoqëri dhe ndërkulturalizmi", një organ i themeluar brenda Qeverisë së Maqedonisë së Veriut nën kujdesin e Zyrës së Kryeministrit. Me nënshkrimin e këtij akti zyrtar, QDN Shkup është zbatuesi i aktiviteteve kryesore në fushën e arsimit ndërkulturor të parashikuar në strategjinë kombëtare "Një shoqëri dhe ndërkulturalizmi".

Një iniciativë tjetër e cila u zyrtarizua në pjesën e parë të vitit 2020 është prezantimi i Modelit Nansen për arsimin ndërkulturor në arsimin e lartë, më saktësisht në Fakultetet Pedagogjike. Qendra për Dialog Nansen në partneritet me organizatën joqeveritare Forum ZFD dhe në bashkëpunim me Fakultetin e Pedagogjisë Shën Klimenti i Ohrit, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të realizimit të trajnimeve ndërkulturore për studentët që janë në vitet e fundit të studimeve universitare. Kjo iniciativë do të na mundësojë të hulumtojmë më tej mundësitë për thellimin e bashkëpunimit me Fakultetin e Pedagogjisë në drejtim të qasjeve dhe ndërhyrjeve arsimore.

Për shkak të pandemisë, i gjithë procesi arsimor filloi të zhvillohej në distancë përmes internetit. Kjo situatë nxorri në sipërfaqe gjendjen e pafavorshme dhe gatishmërinë e pamjaftueshme të institucioneve arsimore për të organizuar mësim të suksesshëm në distancë dhe për të siguruar mbështetje profesionale për mësuesit dhe shkollat për realizimin e aktiviteteve të këtij lloji. Ekipi për arsim, trajnim dhe zhvillim i QDN Shkup, përgatiti dhe siguroi burime të ndryshme arsimore në formë digjitale për mësuesit dhe nxënësit nga shkollat fillore dhe të mesme, nga muaji mars deri në fund të vitit shkollor. Të gjitha këto burime dhe materiale janë përgatitur në tre gjuhë, shqip, maqedonisht dhe turqisht në mënyrë që të lehtësojnë procesin arsimor dhe të sigurojnë burime didaktike të cilat mungojnë në procesin e rregullt arsimor.

Gjatë vitit 2020, Qendra e Trajnimit pranë QDN Shkup organizoi aktivitete dhe trajnime gjatë gjithë vitit. Pas një thirrje të hapur për pjesëmarrësit për programin e trajnimit të Modulit A, QDN Shkup pranoi 230 aplikime, duke rezultuar me një përzgjedhje prej 180 arsimtarësh për të ndjekur një program trajnimi të Modulit A për arsimin ndërkulturor. Përveç arsimtarëve nga Maqedonia e Veriut, QDN Shkup bashkëpunoi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - Misioni në Kosovë, i cili solli mësues nga

bashkësi të ndryshme etnike në Kosovë. Ne gjithashtu bashkëpunuam me Forum ZFD - Kosovë dhe së bashku organizuam një seksion trajnimi mbi ndërkulturalizmin për pjesëmarrësit të cilët ishin studentë nga fakultete të ndryshme të trajnimit të mësuesve në Kosovë.

Në kuadër të bashkëpunimit me Fakultetin e Pedagogjisë në Shkup, QDN Shkup pranoi grupin e parë të studentëve që aplikuan për trajnimin Modul A në kuadër të Qendrës së Trajnimit. Si zakonisht, kalendari i Qendrës sonë të Trajnimit u mbush me trajnime të ndryshme për të cilat siguruam materiale didaktike, multimediale dhe praktike.

Duke marrë parasysh të gjitha pengesat me të cilat përballen mësuesit dhe nxënësit gjatë procesit të mësimit në distancë në kohë pandemie, dhe duke parashikuar pasojat e ndikimit negativ që fatkeqësisht do të ndjehen së shpejti, ekipi ynë entuziast vendosi të hartojë një platformë edukative dhe ndërkulturore "eduresurs.mk" e cila do të jetë krejtësisht e digjitalizuar. Platforma do të sigurojë përmbajtje arsimore dhe burime për përdorim gjithëpërfshirës në procesin e rregullt arsimor dhe një numër të madh të strategjive dhe qasjeve arsimore. Platforma gjithashtu do të sigurojë mbështetje për stafin arsimor në zbatimin e procesit të rregullt arsimor duke forcuar gjithashtu qasjet dhe ndërhyrjet ndërkulturore. Eduresurs.mk do të shërbejë si një qendër burimore për mësuesit, shkollat dhe institucionet arsimore dhe do të jetë në dispozicion në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke.

Ekipi për arsim, trajnim dhe zhvillim shtoi edhe një doracak të vlefshëm në portofolin tonë të pasur. Doracaku "101 lojëra" përmban lojëra të ndryshme argëtuese, të lehta dhe interesante, të përshtatshme për të gjitha grupmoshat. Aktivitetet dhe lojërat e ofruara në këtë doracak mund të realizohen në mjedisin e shkollës, si dhe në familje apo edhe në ambient shtëpiak. Doracaku është përpiluar për të gjithë mësuesit, stafin e arsimit profesional, prindërit dhe nxënësit, dhe i njëjti mund të shkarkohet falas nga faqja jonë e internetit ose edhe mund ta kërkoni në formë të shtypur nga zyra jonë.

2020 ishte një vit i veçantë që shënoi 20 vjetorin e themelimit të Qendrës për Dialog Nansen në Shkup. Me kalimin e viteve, QDN Shkup është bërë një qendër burimesh e cila ofron trajnim, mbështetje profesionale dhe zbatim praktik të politikave të ndryshme arsimore. Logoja e organizatës sonë qëndron me krenari në shumë marrëveshje bashkëpunimi, në shumë çertifikata, në shumë botime, në shumë gjuhë dhe në shumë vende. Logoja e Nansen për shumë individë dhe institucione simbolizon profesionalizmin, vazhdimësinë dhe cilësinë. Për 20 vjet ne kemi lënë një përshtypje pozitive, duke arritur sukses dhe duke ndërtuar bazat për t'u rritur edhe më shumë dhe për të vazhduar këtë udhëtim së bashku edhe për shumë vite të tjera.

STEINAR BRYN
Akademia Nansen, Norvegji
Themelues i rrjetit Nansen

Akoma është herët të dihet se cilat ndryshime janë të përkohshme dhe cilat janë më thelbësore për shkak të përhapjes së virusit Corona. Ajo që është e sigurt është se ne duhet të përmirësojmë aftësinë tonë për t'u përballuar me të papriturat. Siç tha njëherë një politikan i famshëm: ekzistojnë tre gjëra. Së pari janë ato që dimë, së dyti ato gjëra që e dimë që nuk i dimë, dhe së treti ato gjëra që nuk e dimë që nuk i dimë. Ne u kapëm në befasi. Virusi na ka detyruar të rimendojmë konceptet tona më themelore të punës, shëndetit, udhëtimeve, tubimeve shoqërore dhe komunikimit njerëzor. Sfida e veçantë për mësuesit dhe nxënësit është se kjo gjithashtu ndikon në mënyrën se si ne mendojmë për të mësuarit dhe arsimin. Edhe uniteti më themelor, klasa, po pëson ndryshime.

Qendra për dialog Nansen është përqendruar rreth tejkalimit të stereotipave dhe imazheve armiqësore. Strategjia qendrore është ndërtimi i urave për t'i afruar nxënësit nga vijat e ndryshme të ndarjeve kulturore. Unë punoj në Akademinë Nansen në Lillehammer, Norvegji. Gjatë 25 viteve të fundit më shumë se 3000 njerëz nga ish Jugosllavia kanë jetuar dhe bashkëvepruar në këtë cep mjaft të larguar të Evropës. Përmes takimeve sy më sy ata kanë parë që qeniet njerëzore janë shumë më tepër sesa vetëm identiteti i tyre etnik.

Fuqia e këtyre tubimeve ishte se pjesëmarrësit zbuluan aspekte të tjera të personalitetit të njëri-tjetrit. Megjithëse ata erdhën si serbë, shqiptarë, maqedonas, kroatë, boshnjakë etj., dhe megjithëse erdhën me narrativa mjaft fikse të asaj që shkaktoi prishjen e Jugosllavisë, vetë takimi me të tjerët zgjeroi horizontet e tyre dhe tregoi se të gjithë njerëzit kanë identitete të shumëfishta. Njerëzit mund të kenë një konflikt të vërtetë si maqedonas dhe shqiptarë, por dhe interesa të përbashkëta si avokatë, mësues, prindër dhe valltarë. Përmes krijimit të besimit dhe respektit në arenat e tjera të jetës u bë më e lehtë për të folur për vetë konfliktet dhe për të dëgjuar historitë e njëri-tjetrit.

Covid-19 përsëri ka rritur ndarjen midis njerëzve përmes kufizimeve të lëvizjes dhe tubimeve të njerëzve. Puna e Qendrës për Dialog Nansen ka pësuar gjithashtu pasi që tubimet e mëdha të studentëve janë anuluar. Kur ju duhet patjetër të zgjidhni vetëm disa njerëz për të bashkëvepruar, ju sigurisht që i zgjidhni njerëzit tuaj. Kufijtë janë të mbyllur, të huajt janë bartës të mundshëm të infeksioneve dhe komunikimi ngadalësohet në të gjitha anët.

Është një klishe, por ndonjëherë edhe e vërtetë, që kur mbyllet një derë mund të hapet një derë tjetër. QDN Shkup ka përballuar sfida të mëdha në mënyrë që të vazhdojë punën arsimore në Maqedoninë e Veriut.

Këto sfida janë përballuar me një përgjigje të fortë digjitale. Ne dimë mirë që t'i vëmë në pah kufizimet e takimeve digjitale, por në këto rrethana ato janë opsioni më i mirë që kemi në dispozicion. Unë kam dhënë leksione të shumta përmes platformës Zoom, dhe në fillim edhe pse ishte shumë e çuditshme, ajo kishte edhe përparësi të dukshme. Në seminaret Zoom mund të merrnin pjesë njerëz që nuk mund të udhëtonin. Në seminaret e Qendrës Nansen për Dialog mund të kemi njerëz që takohen nga vende të ndryshme me një kosto shumë të ulët. Kam mbajtur ligjerata në ngjarjen përmbyllëse të trajnimit të mësuesve "Sfidat e arsimit ndërkulturor", një ligjeratë që më parë do ta mbaja në një sallë konferencash në Shkup.

Kam mësuar diçka të rëndësishme. Unë kam vënë re që shumë njerëz mund ta ndiejnë një hotel si një vend solemn dhe nuk është edhe aq e lehtë të mbash fjalime para 100 kolegëve mësues. Kur ulen në rrethin e tyre të njohur, disa nga mësuesit ndihen më të lirë për të treguar historitë e tyre të vogla. Takimi digjital nuk i largoi ata, përkundrazi, më shumë pjesëmarrës ndiheshin më të lirë të flisnin. Unë gjithashtu mbajta një ligjeratë përmes Zoom për studentët e Fakultetit të Pedagogjisë Shën. Klimenti i Ohrit, Shkup. Aty ndjeva më shumë një lodhje nga Zoom dhe nevojën për një takim fizik.

Pasojat e plota të Covid-19 nuk janë të njohura për ne por duhet të jemi kreativë në përgjigjen tonë për të vazhduar promovimin e Modelit Nansen për arsim ndërkulturor. Një psikiatër me emrin Viktor Frankl, përjetoi ngjarjet më brutale gjatë Luftës së Dytë Botërore, por thelbi i mençurisë së tij jetësore ishte që në një situatë të caktuar sfiduese njeriu duhet të nxjerrë më të mirën e mundshme prej së njëjtës situate. Kjo është pikërisht ajo që unë mendoj se QDN Shkup ka arritur të bëjë me punën e tyre arsimore gjatë Covid-19.

Megjithatë, Qendra për Dialog Nansen duhet të vazhdojë të promovojë dialogun e drejtëpërdrejtë (sy më sy) si mënyra përfundimtare e favorshme e komunikimit. Një ligjeratë përmes Zoom është një ligjeratë e planifikuar. Ndërtimi i marrëdhënies së drejtpërdrejtë midis njerëzve që ndodhi në Akademinë Nansen ndonjëherë mund të prodhojë mendime dhe reflektime të reja, dhe mund të mundësojë lindjen e ideve befasuese. Në një takim në Zoom ju shpesh keni mundësinë për të thënë gjithçka që dëshironi të thoni, por kjo njëkohësisht është gjithçka që ju mundësohet për të thënë. Kur largoheni nga takimi, ju gjithashtu largoheni nga biseda. Në një takim me pjesëmarrje fizike ju nuk keni nevojë të largoheni dhe keni kohë që të pathënat dhe të pamenduarat t'i shprehni në vijim të bisedës në një mënyrë më joformale.

SHËNIMI I PËRVJETORIT TË 20-TË QËNDRES PËR DIALOG NANSEN NË SHKUP

Këtë vit, Qendra për Dialog Nansen Shkup (QDN) feston dy dekada punë dhe përkushtim për zhvillimin e arsimit ndërkulturor në Maqedoninë e Veriut, duke pasur nxënësit, prindërit, mësuesit dhe institucionet si partnerët e saj në atë proces.

Gjatë gjithë këtyre viteve, QDN është udhëhequr nga vizioni i saj - një shoqëri në të cilën të gjithë kanë qasje të barabartë në arsim cilësor të bazuar në ndërkulturalizëm, integrim ndëretnik dhe kohezion.

Për 20 vjet, QDN ka përmbushur misionin e saj - mbështetje dhe kontribut në zhvillimin e arsimit përmes zhvillimit të institucioneve edukuese dhe arsimore, politikave dhe praktikave, si dhe promovimit të dialogut në parandalimin e konflikteve, përmes pajtimit dhe ndërtimit të paqes në shoqëri.

E themeluar në vitin 2000, QDN ka luajtur një rol vendimtar në rivendosjen e besimit midis bashkësive etnike në zonat e prekura nga konflikti i vitit 2001, kështu që sot mund të flasim për hollësitë e nevojshme që Maqedonia e Veriut të bëhet një shoqëri për të gjithë.

"Puna për parandalimin e konflikteve nuk mund të përcaktohet lehtësisht me numra. Nuk është e lehtë të matet besimi mes komuniteteve ose niveli i mirëkuptimit dhe tolerancës në terrenin e shkollës, ose dëshira për të dëgjuar palën tjetër dhe për të bashkëpunuar. Megjithatë, QDN Shkup ka arritur rezultate të prekshme që mund t'i rezistojnë edhe shqyrtimit më të hollësishëm " Knut Vollebeak (Komisari i Lartë për Pakicat Kombëtare, 2011).

Në arritjen e qëllimeve, është e rëndësishme të theksohet se puna e QDN Shkup filloi pikërisht nga ata që do të ndërtojnë një të ardhme të përbashkët - të rinjtë në arsimin fillor. Falë qasjes modeste, fëmijëve nga bashkësi të ndryshme etnike u sigurohet një mjedis në të cilin gjatë viteve ata kanë pranuar se gjuha, kultura, tradita, vlerat, besimet etj., janë përbërës të unitetit, jo të ndarjes.

Në periudhën 2000-2004, QDN ishte më e përqendruar në bashkëpunimin me vendet në rajon përmes seminareve dhe forumeve me gazetarë, udhëheqës të rinj dhe politikanë të rinj. Në vitin 2003, ajo organizoi Shkollën për Politikanët e Rinj në Ohër. Programi i titulluar "Dialogu dhe Pajtimi" filloi në 2005 në Komunën e Jegunovcës, e cila karakterizohej nga ndarja e theksuar etnike pas konfliktit të armatosur në 2001. Aktiviteti i QDN u mbështet fuqimisht nga banorët lokalë, gjë që rezultoi me shkollat e para të integruara dygjuhëshe në vend, të themeluara në fshatin Preljubishtë në vitin 2008 dhe në vitin 2010.

"Në vitin 2011, QDN mori çmimin prestigjioz Max van der Stoel nga OSBE për promovimin e arsimit të integruar dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis komuniteteve etnike. Juria ndërkombëtare vendosi të shpërblejë QDN Shkup për "punën e jashtëzakonshme në promovimin e arsimit ndërkulturor dhe promovimin e bashkëpunimit midis bashkësive etnike".

"Përmes përpjekjeve të tyre të palodhshme dhe projekteve inovative, QDN Shkup ka siguruar prova të mëtejshme të rolit pozitiv që arsimi mund të luajë në zbutjen e tensioneve ndëretnike dhe integrimin e shoqërisë. Shkollat e saj të integruara dygjuhëshe janë modele për promovimin e respektit për diversitetin, dygjuhësinë dhe marrëdhëniet harmonike midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve të tyre nga prejardhje të ndryshme etnike. Në shumë aspekte, QDN Shkup ka vazhduar trashëgiminë e rëndësishme të lënë nga i ndjeri Max van der Stoel në vend. Puna e arritur është një burim i madh frymëzimi për të gjithë ata që janë angazhuar për të kapërcyer ndarjen etnike në mjediset pas konfliktit."
Juria e çmimit Max van der Stoel 2011

The Selection Jury
for the Max van der Stoel Award
has decided to confer on

Nansen Dialogue
Centre Skopje

the ***MAX VAN DER STOEL*** *award*
2011

in recognition of its extraordinary and outstanding
achievements in improving the rights and position of
national minorities in the OSCE participating states

The Hague, 24 October 2011

H.E. Mr. Knut Vollebaek
Mr. Wilco de Jonge
Ms. Chinara Jakypova
Ms. Gay McDougall
Ms. Anastasia Crickley
Mr. Emil Pain

QDN Shkup ka prezantuar Modelin Nansen për arsim ndërkulturor (NMIE) në Maqedoninë e Veriut, i cili është zbatuar në më shumë se 30 shkolla fillore dhe të mesme. NMIE dhe programet për arsimin ndërkulturor, vazhdojnë të trajtojnë një nga çështjet më të kritike e cila është përbashkët për tërë rajonin e Ballkanit - ndarja e shkollave mbi bazat etnike dhe mungesa e komunikimit midis nxënësve, mësuesve dhe prindërve me prejardhje të ndryshme etnike dhe fetare.

QDN Shkup ka theksuar rolin e arsimit ndërkulturor dhe në përputhje me parimet e tij themelore mbështet mësuesit në plotësimin e nevojave arsimore të një popullate të larmishme nxënësish. Në këtë mënyrë, ajo inkurajon shkollat dhe shoqërinë, si individualisht ashtu edhe kolektivisht, të shqyrtojnë procesin arsimor dhe të përfshijnë parimet multikulturore në programet e tyre mësimore dhe në ambientin e klasës, gjë që rezulton në ndërtimin e urave midis komuniteteve që jetojnë paralelisht njëra pranë tjetrës. Kjo u arrit përmes punës së Qendrës së Trajnimit të Modelit Nansen për Arsim Ndërkulturor të themeluar në vitin 2012. Qendra e Trajnimit është e para e këtij lloji në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon, prandaj interesi për të ndjekur programet e trajnimit mbetet i lartë që nga themelimi i saj.

QDN Shkup gjithashtu ka përgatitur shumë dokumente strategjike, përfshirë Konceptin për Arsimin Ndërkulturor, shumë doracakë didaktikë, hulumtime cilësore, libër bashkëbisedimesh dhe fjalor të dyanshëm Maqedonisht-Shqip dhe Shqip-Maqedonisht, etj.

PARTNERITETET STRATEGJIKE PËR AVANSIMIN E NDËRKULTURALIZMIT NË ARSIM

Përpjekjet e përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare për mbështetjen dhe avancimin e iniciativave të arsimit ndërkulturor dhe reformave kuptimplota në sektorin e arsimit rezultojnë në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira që mund të zbatohen dhe zhvillohen më tej në një kontekst specifik.

Në vitin 2020, QDN Shkup vazhdoi të forcojë marrëdhëniet e partneritetit me organizatat ekzistuese partnere dhe zhvilloi partneritete dhe iniciativa të reja që sollën rezultate inkurajuese. Në periudhën raportuese, QDN Shkup vazhdoi të ndajë praktikat më të mira nga përvoja e gjerë në fushën e arsimit ndërkulturor, si dhe të fitojë perspektivë dhe njohuri të reja në lidhje me trendet dhe zhvillimet më të fundit në fushën e arsimit.

Vendosja e bashkëpunimit me Qeverinë e Maqedonisë së Veriut

Në Mars të vitit 2020, Qendra e Dialogut Nansen Shkup nënshkroi një Memorandum për bashkëpunim me Qeverinë duke theksuar bashkëpunimin me Trupin Koordinues për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare: Një shoqëri dhe ndërkulturalizmi. Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është të mbështesë dhe të kontribuojë drejt forcimit të iniciativave ndërkulturore në shumë fusha jetësore të jetës shoqërore, siç janë: arsimi, kultura, vetëqeverisja lokale, media, korniza ligjore dhe rinia.

QDN Shkup jep një kontribut të çmuar në fushën e arsimit, përfshirë aktivitetet në fushën e saj të fokusit - arsimin ndërkulturor. Bashkëpunimi do të ketë një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në sensibilizimin e stafit edukativ dhe arsimor në vend për shumë aspekte të arsimit ndërkulturor.

Gjatë vitit 2020, QDN Shkup dha bursa trajnimi dhe siguroi trajnime interaktive për 182 mësues nga shkollat fillore dhe të mesme nga të gjitha rajonet e vendit që do të japin një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e konceptit të arsimit ndërkulturor si një nga përparësitë kryesore për shoqërinë tonë që më në fund të bëhet një shoqëri për të gjithë.

Bashkimi i ekspertizës me Forumin Ziviler Friedensdienst për të trajnuar mësuesit e ardhshëm

Si organizata partnere, më 5 mars 2020, QDN Shkup dhe Forum ZFD nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me Fakultetin e Pedagogjisë Shën Kliment i Ohrit, Shkup. Qëllimi kryesor i krijimit të këtij bashkëpunimi është zbatimi i ciklit të trajnimit ndërkulturor për studentët që janë në vitet e tyre të fundit të studimeve universitare.

Trajnimet do t'u mundësojnë studentëve të jenë të vetëdijshëm për sfidat e shumta të arsimit ndërkulturor, si në nivel lokal ashtu edhe global. Ato gjithashtu do të mundësojnë rishikimin e një numri të madh të qasjeve dhe ndërhyrjeve arsimore.

Aktivitetet e parashikuara në këtë iniciativë do të përgatisin mësuesit e ardhshëm në ndërtimin e kompetencave ndërkulturore të kërkuara për angazhimin e tyre të mëtejshëm profesional. Programi i trajnimit do të mundësojë marrjen e njohurive dhe aftësive dhe do të sensibilizojë studentët për sfidat e arsimit ndërkulturor. Trajnimet realizohen në tre gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip, turqisht), duke mundësuar kështu pjesëmarrjen e të gjithë studentëve të interesuar nga Fakulteti Pedagogjik.

Përgjigja ndaj nevojave të shkollave në kohë të pandemisë COVID-19

Mbështetje e përbashkët për shkollat në partneritet me Ambasadën Norvegjeze në Beograd

Mes shumë sfidave të shfaqura nga jeta e përditshme në një pandemi, ishte veçanërisht e rëndësishme të mos harrojmë ata që kishin më shumë nevojë për kujdes, mbrojtje dhe vëmendje - fëmijët!

Qendra e Dialogut Nansen në Shkup dhe Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë me qendër në Beograd, së bashku përgatitën një donacion prej 100 paketash me dezinfektues dhe produkte higjienike për disa shkolla fillore në vend.

Shkollat nga Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Dibra, Manastiri, Krusheva, Borina, Kanatlari dhe Konçe kanë qenë partnerë të dëshmuar për shumë vite në zbatimin e Modelit Nansen për arsimin ndërkulturor, dhe donacioni kontribuoi në sigurimin e një ambienti më të sigurt shkollor dhe mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve dhe mësuesve.

QENDRA PËR TRAJNIM – MODELI NANSEN PËR ARSIM NDËRKULTUROR

Qendra e Trajnimit pranë QDN Shkup hyri në vitin 2020 me shumë plane, iniciativa dhe ide të reja, të cilat do të promovonin arsimin ndërkulturor si një element strukturor në procesin e përditshëm arsimor. Kjo është arsyeja pse kemi kryer disa modifikime të programeve në ofertën arsimore të Qendrës sonë të Trajnimit, të cilat për kënaqësinë tonë të madhe u pranuan pozitivisht nga gati dyqind mësues, profesorë, bashkëpunëtorë profesionalë, edukatorë dhe studentë.

Entuziazmi reciprok krijoi një sinergji të fortë midis trajnuesve, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, si bashkëpunëtorë tanë të vjetër dhe njëkohësisht edhe pjesëmarrës në trajnime, i cili ishte thelbësor për vitin 2020 që u vu nën hije nga pandemia, për t'u shndërruar në një vit që do të bartë epitetet e konstruktivitetit, motivimit, bashkëpunimit, të plotësuara me shumë përvoja të reja, njohuri, aftësi, por edhe miqësi.

Ne jemi thellësisht krenarë që Qendra jonë e Trajnimit është njohur si një thesar i ndërveprimit, bashkëpunimit, besimit, shumëgjuhësisë dhe diversitetit kulturor në nëntë muajt e fundit, duke pasur parasysh që ne u përballëm me një nga sfidat më të mëdha dhe më komplekse deri më tani: si të mirëmbajmë komunikim të pasur, shumëgjuhësh dhe bashkëpunim grupor të natyrshëm, të drejtpërdrejtë, dhe spontan midis pjesëmarrësve në kushte pandemike dhe në pamundësi për të organizuar fizikisht procesin e trajnimit. Strategjia për riorganizimin e trajnimeve dhe shndërrimin e tyre në një produkt arsimor ndërkulturor efikas 'online' dhe të njohur u zhvillua me kujdes. Qëllimi ynë ishte të ofrojmë përmbajtje dhe punëtori 'online' që do të mbajnë vëmendjen, interesin dhe kuriozitetin e pjesëmarrësve, dhe në të njëjtën kohë të bëhemi model dhe shembull i një 'online' praktike të suksesshme, e cila është vetëm e modifikuar në një dimension tjetër.

Me shumë kujdes dhe përkushtim, u krijuan të gjitha segmentet e puntorive në mënyrë që të ruanin tiparet e trajnimeve siç janë: loja, shumëgjuhësia, zbatueshmëria, simulimi i situatave problemore, loja me role, etj., gjë që rezultoi në një përvojë të re e të dobishme për të gjithë ne. Ishte ky hap i veçantë që profilizoi Qendrën tonë të Trajnimit në një qendër burimesh interaktive dhe atyre në distancë (online). Ne e pranojmë që misioni kryesor i veprimit tonë duhet të jetë qasja dhe mbështetja për iniciativa dhe ide që çojnë në sensibilizimin ndërkulturor të të gjitha subjekteve arsimore.

Jemi mirënjohës që në vitin 2020, gjithsej 240 punonjës arsimorë të tanishëm dhe të ardhshëm na besuan dhe ishin drejtuesit kryesorë të gjashtëdhjetë trajnimeve të realizuara në rrethana vërtet specifike.

Kjo është arsyeja pse ne po presim me padurim vitin 2021, me shpresën se ky rrjet i bashkëpunëtorëve, miqve dhe mbështetësve tanë do të zgjerohet dhe pasurohet!

Ne shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë të cilët me vetëmohim ndihmuan në ndërtimin e imazhit pozitiv të Qendrës sonë të Trajnimit!

Ju presim në vitin e ardhshëm me shëndet të mirë dhe një mendim pozitiv!

BILJANA KRSTESKA – PAPIQ
Menaxhere e projektit

Përmirësimi i vazhdueshëm i njohurive dhe kompetencave ndërkulturore

Qendra e Trajnimit - Modeli Nansen për arsimin ndërkulturor vazhdimisht vepron me misionin dhe qëllimin për të përmirësuar cilësinë e procesit arsimor në Maqedoninë e Veriut; ngritja e njohurive ndërkulturore dhe zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive ndërkulturore; përhapja e idesë dhe filozofisë së qasjes Nansen; stimulimi i transformimit profesional dhe personal të mësuesve si dhe mbështetja e qasjes anti-paragjykuese në mjedisin shkollor multietnik.

Gjatë vitit 2020, Qendra e Trajnimit QDN Shkup vazhdoi të sigurojë programe për ndërtimin e kapaciteteve për mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme, bashkëpunëtorët profesional, si dhe studentët nga Fakulteti Pedagogjik, pavarësisht nga sfidat me të cilat shoqëria u përball mes pandemisë COVID-19.

Arritjet kryesore gjatë vitit raportues:

- Krijimi një programi të ri trajnimi për arsimin ndërkulturor MODULI A
- Dhënia e bursave për 182 mësues dhe bashkëpunëtorë profesionalë
- Zbatimi me sukses i MODULIT A një cikël trajnimi për 182 mësues dhe bashkëpunëtorë profesional (Grupi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8) i realizuar përmes gjithsej 38 seancave trajnuese
- Realizimi me sukses i ciklit të trajnimit për një grup prej 13 studentësh nga Fakulteti Pedagogjik

Hartimi i programeve të reja të azhurnuara të trajnimit

Përgatitja e programeve dhe moduleve arsimore bazohet në rekomandimet dhe zgjidhjet afatgjate dhe zhvillimore të inkorporuara në planin strategjik të titulluar "Koncepti për arsimin ndërkulturor". Duke u nisur nga vizioni i tij i forcimit të marrëdhënieve ndërkulturore dhe proceseve integruese, si dhe krijimi i një mjedisi edukues dhe arsimor për promovimin e larmive kulturore, të gjitha aspektet e edukimit dhe punës arsimore në shkollat fillore dhe të mesme u morën parasysh gjatë hartimit të ofertës programore të Qendrës së Trajnimit për Arsim Ndërkulturor, siç janë:

» përmbajtja e punës,
» format, metodat dhe teknikat e të mësuarit dhe mësimdhënies,
» tekste shkollore, materiale dhe pajisje të tjera,
» aktivitete jashtëshkollore,
» kompetencat e mësuesve, bashkëpunëtorëve profesional dhe drejtorëve,
» mjedisi i institucioneve edukative dhe arsimore, dhe
» marrëdhëniet midis edukimit, institucioneve arsimore dhe komunitetit më të gjerë.

Programet dhe modulet janë strukturuar në disa fusha të veçanta bazuar në tema shumështresore që do t'u mundësojnë të gjithë pjesëmarrësve në procesin e trajnimit të njihen me konceptin dhe idenë e arsimit ndërkulturor dhe politikat për zbatimin e suksesshëm të këtij koncepti arsimor në mjediset shkollore ndërkulturore.

Në të njëjtën kohë, modulet e siguruara do t'u mundësojnë të gjithë pjesëmarrësve të njihen drejtpërdrejtë me aspektet pozitive të qasjes ndërkurrikulare në zbatimin e iniciativave të ndryshme ndërkulturore në sferën e arsimit, si një trend bashkëkohor pedagogjik dhe një sfidë globale edukative dhe arsimore.

Pjesëmarrësit në këtë lloj trajnimi do të kenë mundësinë të zhvillojnë, përvetësojnë dhe përmirësojnë ndjekjen e tre llojeve të aftësive dhe kompetencave, si standarde të programit:

» kompetencat personale dhe ndërpersonale,

» kompetencat ndërkurrikulare,

» aftësitë kognitive dhe kreative.

Qëllimet e programit të trajnimit për arsimin ndërkulturor (MODULI A):

- Aftësim për organizim dhe realizim të pavarur të aktiviteteve të ndryshme edukative dhe arsimore;
- Sensibilizimi drejt respektimit të diversitetit në mjedisin shkollor dhe tejkalimi i stereotipave dhe paragjykimeve të ndryshme - sociale, etnike, kulturore, etj.;
- Promovimi i rëndësisë së qasjes së individualizuar sipas potencialeve dhe aftësive individuale të nxënësve;
- Aftësimi i realizuesve të aktiviteteve për zbatim të duhur dhe të suksesshëm të punës në tandem dhe ekip;
- Njohja e veçorive dhe përfitimeve pozitive të qasjes së bazuar në lojë në aktivitetet edukative dhe arsimore;
- Sensibilizimi i realizuesve të aktiviteteve për të mbështetur kureshtjen dhe origjinalitetin e fëmijëve, si dhe potencialet kreative të nxënësve;
- Përfshirja e teknikave për inkurajimin dhe zhvillimin e të menduarit logjik, fleksibil, divergjent dhe kritik midis nxënësve;
- Përforcimi i ndërveprimit, bashkëpunimit dhe besimit ndërmjet stafit mësimdhënës të komuniteteve të ndryshme etnike.

PËRMBJTJA DHE STRUKTURA E TRAJNIMIT

Bashkëpunimi me Fakultetin e Pedagogjisë

Vendosja e lidhjes domethënëse midis programit të studimeve zyrtare dhe përvojës së Nansen në arsimin ndërkulturor

Në vitin 2020, Qendra e Trajnimit pranë QDN Shkup filloi trajnime me grupin e parë të studentëve nga Fakulteti Pedagogjik Shën Kliment i Ohrit, Shkup, si një reflektim i nevojës aktuale për sensibilizim ndërkulturor të studentëve si mësues të ardhshëm. Gjatë periudhës së përgatitjes të këtij raporti, studentët patën mundësinë të ndiqnin gjashtë seanca trajnimi me një larmi aktivitetesh teorike dhe praktike.

Theksi dhe fokusi i bashkëpunimit me Fakultetin Pedagogjik është në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive ndërkulturore të studentëve, paralelisht me procesin e profilizimit të tyre profesional. Marrëdhëniet e partneritetit u iniciuan në drejtim të menaxhimit të mëtejshëm, të ardhshëm, më të lehtë të sfidave ndërkulturore nga studentët në praktikën e menjëhershme, qoftë në institucionet parashkollore ose në mësimin në klasë.

Duke vendosur bashkëpunim me Fakultetin Pedagogjik në Shkup, është krijuar një lidhje e rëndësishme midis disa prej përmbajtjeve të studimeve universitare dhe programeve që ofron Qendra e Trajnimit.





Mbështetje për Strategjinë Kombëtare - Një shoqëri për të gjithë dhe ndërkulturalizmi

Zbatimi praktik i fushës së dytë tematike të Konceptit për arsimin ndërkulturor "Kompetencat për arsimin ndërkulturor të kuadrit mësimor"

Bursat për mësuesit - MODULI A, trajnim mbi arsimin ndërkulturor

Më 28 janar 2020, Qendra e Trajnimit për Arsim Ndërkulturor – Qendra për Dialog Nansen në Shkup, në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të Irlandës Veriore për Arsim të Integruar (NICIE), shpalli një thirrje të hapur për ndarjen e bursave për trajnim në arsimin ndërkulturor si pjesë e Strategjisë Kombëtare për zhvillimin e konceptit "Një shoqëri për të gjithë dhe ndërkulturalizmi".

Thirrja publike për programin e trajnimit ishte e paraparë për mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesional nga të gjitha shkollat fillore dhe të mesme. Pas përfundimit të afatit të aplikimit dhe procesit të përzgjedhjes, gjithsej 182 mësues dhe bashkëpunëtorë profesionistë u kyçën në programin e trajnimit të organizuar në tetë grupe. Interesi i mësuesve nga shkollat fillore dhe të mesme në Maqedoninë e Veriut për programin e trajnimit në kuadër të Qendrës së Trajnimit po rritet çdo vit, gjë që është një tregues i fortë i rëndësisë së Qendrës së Trajnimit në fushën e arsimit ndërkulturor dhe zhvillimit profesional të të gjithë pjesëmarrësve në procesin arsimor.

Përfundimi i suksesshëm i programit të trajnimit për arsim ndërkulturor

Në shtator të vitit 2020, Qendra e Trajnimit pranë QDN Shkup shënoi përfundimin me sukses të ciklit të trajnimit MODULI A për arsimin ndërkulturor duke dhënë certifikata për 182 mësues, bashkëpunëtorë profesionalë, profesorë nga të tetë grupet e Qendrës së Trajnimit. Qendra e Trajnimit pranë QDN Shkup organizoi gjithsej 38 seanca trajnimi në periudhën shkurt - shtator 2020.

Me këtë rast, këmbëngulja, përkushtimi dhe motivimi i pjesëmarrësve u theksuan në fjalimet uruese nga drejtori ekzekutiv i QDN Shkup, z. Veton Zekolli dhe drejtoresha e Këshillit për arsim të integruar i Irlandës Veriore, znj. Roshin Marshall.

Cikli i trajnimit ofroi një hyrje të hollësishme në të gjithë atë që qëndron ende përpara arsimit ndërkulturor si një nevojë aktuale në praktikën tonë arsimore. Iniciativat e ardhshme që do të mbështeten nga ky grup mësimdhënësish të trajnuar me të vërtetë do të kenë një ndikim pozitiv në cilësinë e arsimit në vendin tonë.

Ne vlerësojmë opinionet dhe mbështetjen e mësuesve tanë!

Ishte kënaqësi të marr pjesë në trajnimet tuaja dhe sinqerisht, mësova shumë! Shpresoj se do të kemi shumë mundësi tjera bashkëpunimi që të mësojmë edhe më shumë!

Nebushe Ajeti
Profesoreshë e artit
ShFK Petar Zdravkovski-Penko, Shkup

Shpreh mirënjohjen time për qëndrueshmërinë, përmbushjen dhe bashkëpunimin e mrekullueshëm, i cili shpresoj të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Milena Simoska
Profesoreshë e pedagogjisë dhe edukimit
qytetar ShMQSh Georgi Dimitrov, Shkup

Faleminderit për trajnimin me cilësi të lartë dhe energjinë pozitive! Kam mësuar shumë dhe ju përmend shpesh si trajnerë. Shpresoj se do të takohemi përsëri në të ardhmen.

Sinoliçka Sabotkovska
Profesoreshë e gjuhës maqedonase dhe gjermane
ShFK Brakja Miladinovci, Dobrushevë,
Komuna e Mogillës

Ju falënderoj për gjithçka, që më dhatë mundësinë të jem pjesë e programit tuaj. Metoda e punës që aplikoni, ju bën unikë. Ju uroj suksese të mëtejshme!

Mimoza Mustafai-Jonuzi

Profesoreshë e gjuhës shqipe
ShF Naim Frashëri, Studeniçan, Shkup

Unë me të vërtetë isha i kënaqur të punoj me ju, ndërkaq njohuritë e fituara dhe kanalizimi i njohurive tashmë të fituara, do të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në punën time.

Aleksandar Mihajloviç

Mësues klasor
ShFK Dençe Dejanoski - Mavrovi Anovi

Faleminderit shumë për përvojën e mrekullueshme, shoqërimin, argëtimin dhe sigurisht zhvillimin profesional.
Presim bashkëpunimin e radhës me ju!

Maja Kostova

Nëndrejtor
ShPP Jahja Kemal, Shkup

Nuk mund të gjej fjalë të mjaftueshme për t'ju falënderuar për punën tuaj, përkushtimin dhe respektin që keni treguar gjatë këtij bashkëpunimi. Një falënderim i madh për ju!

Naser Miftari

Porfesor i historisë
ShMQSh Zef Lush Marku, Shkup

Ekipi i trajnuesve për vitin 2020

Dr. Biljana Krsteska-Papiq

Mr. Sonaj Bilal

Dr. Osman Emin

Prof. Dr. Ognen Spasovski



Prof. Dr. Steinar Bryn

Përmbledhje e aktiviteteve të Qendrës së Trajnimit gjatë vitit 2020

SHKURT **1. Punëtoria 1** » (ekipi i QDN Shkup)	Grupi 1.	18.02.2020
	Grupi 2.	19.02.2020
	Grupi 3.	20.02.2020
	Grupi 4.	21.02.2020
	Grupi 5.	24.02.2020
	Grupi 6.	25.02.2020
	Grupi 7.	27.02.2020
	Grupi 8.	28.02.2020
QERSHOR **Punëtoria 2 dhe 3** » (ekipi i QDN Shkup)	Grupi 1.	08.06. dhe 22.06.2020
	Grupi 2.	09.06. dhe 23.06.2020
	Grupi 3.	10.06. dhe 24.06.2020
	Grupi 4.	11.06. dhe 26.06.2020
	Grupi 5.	12.06. dhe 29.06.2020
	Grupi 6.	15.06. dhe 30.06.2020
	Grupi 7.	16.06.2020
	Grupi 8.	17.06.2020
KORRIK **3. Punëtoria** » (ekipi i QDN Shkup)	Grupi 7.	02.07.2020
	Grupi 8.	03.07.2020
	*shënim: punëtoritë e trajnimit 'online' u organizuan duke filluar nga qershori	
SHTATOR **Punëtoria 5, 6 dhe 7** Punëtoria 5 » Prof. Dr. Ognen Spasovski Punëtoria 5 » Prof. Dr. Steinar Bryn Punëtoria 5 » ekipi i QDN Shkup + fjalë rasti nga Roshin Marshall, Drejtoreshë Ekzekutive e NICIE	Grupi 1. dhe 2.	01.09.2020
	Grupi 3. dhe 4.	02.09.2020
	Grupi 5. dhe 6.	03.09.2020
	Grupi 7. dhe 8.	07.09.2020
	Grupi 1. - 4.	14.09.2020
	Grupi 5. - 8.	16.09.2020
	Grupi 1.	21.09.2020
	Grupi 2.	22.09.2020
	Grupi 3.	23.09.2020
	Grupi 4.	24.09.2020
	Grupi 5.	25.09.2020
	Grupi 6.	28.09.2020
	Grupi 7.	29.09.2020
	Grupi 8.	30.09.2020


Blerim Kelmendi
NDC Skopje
Ana
Sonaj Bilal
Eldin Veljan
Zyrafete Kamberaj
Antoneta
Albulena
Sevda Kandic
H
Hysnie Hamiti

MODELI NANSEN PËR ARSIM NDËRKULTUROR

Viti që lamë pas, ishte një vit ndryshimesh dhe sfidash. Pandemia na preku në mënyra që nuk mund t'i imagjinonim kurrë, duke prekur dukshëm çdo aspekt të punës dhe jetës sonë. Të gjithëve na është dashur t'i përshtatemi situatës së re dhe mënyrave të ndryshme të jetesës dhe punës.

Në një përpjekje për të parandaluar përhapjen e Covid-19, institucionet arsimore në shumicën e vendeve në botë vendosën të mbyllen dhe të kalojnë në mënyra të ndryshme të mësimit në distancë. Të njëjtën gjë kanë bërë edhe shkollat dhe universitetet në vendin tonë. Ata u zhvendosën në mënyrat tjera të punës përmes internetit në mënyrë që të mbajnë nxënësit të angazhuar në mësime, dhe në mënyrë që të mos ndalojnë procesin e rregullt mësimor. E gjithë kjo shkaktoi ngarkesë dhe përgjegjësi shtesë për të gjitha palët e përfshira, veçanërisht për mësuesit, nxënësit dhe prindërit. Përveç procesit të rregullt mësimor, "realiteti i ri" preku edhe aktivitetet jashtëmësimore, kështu që shkollat që zbatojnë Modelin Nansen për arsim ndërkulturor nuk ishin në gjendje të vazhdojnë aktivitetet e tyre javore me grupe të ndryshme të nxënësve.

Në përputhje me situatën e re, dhe në frymën e të gjitha rekomandimeve dhe udhëzimeve të dhëna nga institucionet përkatëse, Qendra për Dialog Nansen Shkup u dha mbështetjen e saj mësimdhënësve, duke ofruar doracakët elektronikë dhe përmbajtje të ndryshme të destinuara për kuadrin arsimor. Përmbajtjet e ofruara lidheshin ngushtë me disa lëndë të ndryshme shkollore dhe ishin shumë të dobishme për të gjithë mësimdhënësit në formësimin e përmbajtjeve të mësimit në distancë. Temat, aktivitetet dhe burimet e ndryshme që u ofruan ishin të llojit që mund të adaptohet dhe modifikohet lehtësisht për t'u përdorur edhe nga prindërit në shtëpi.

Shtyllat themelore të arsimit ndërkulturor si: ndjeshmëria, solidariteti, respekti, shkëmbimi, etj., mund të promovohen lehtësisht, drejtpërdrejt dhe vazhdimisht përmes lojërave të ndryshme. Prandaj, gjatë kësaj periudhe QDN Shkup krijoi një doracak të ri për mësuesit, edukatorët, nxënësit dhe prindërit. Doracaku "101 lojëra" përmban një mori lojërash të lehta, interesante dhe argëtuese për fëmijë të të gjitha moshave. Lojërat janë një mjet kryesor i ndërhyrjeve arsimore ndërkulturore dhe ato inkurajojnë zhvillimin spontan të komunikimit të ndërsjellë, bashkëpunimit, mbështetjes, ndarjes së ideve etj. Lojërat që ofrohen në këtë doracak janë mjaft të larmishme dhe mund të zbatohen në shkollë dhe gjatë orëve 'online' (për lëndë të ndryshme shkollore), si dhe në shtëpi.

Ndryshimet dhe sfidat me të cilat u përballëm na dhanë mundësinë për të zhvilluar ide të reja. Këtë vit, QDN Shkup po vazhdon me iniciativa të reja kreative për promovimin e vlerave ndërkulturore jo vetëm përmes aktiviteteve jashtëmësimore, por edhe përmes procesit të rregullt mësimor

SONAJ BILAL
Menaxhere e projektit

Qasja Nansen për arsim ndërkulturor - një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave të shumta

Komponentët e programit të modelit Nansen për arsim ndërkulturor kanë funksionuar në atë mënyrë që kanë transformuar jo vetëm individët e përfshirë në program, por edhe institucionet arsimore si një metaforë dhe mekanizëm për transformimin e shoqërisë.

Modeli Nansen për arsim ndërkulturor vazhdon të përfaqësojë një përgjigje bashkëkohore të nevojës për komunikim dhe bashkëpunim në punën arsimore ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike që jetojnë në Maqedoninë e Veriut dhe përfaqëson një mjet kryesor në procesin e fillimit dhe mbështetjes së ndërtimit të marrëdhënieve ndërvepruese dhe harmonike në komunitet. Përmes programeve vjetorë për aktivitete jashtëmësimore të integruara të hartuara nga ekipi i QDN Shkup për arsim, trajnim dhe zhvillim, tandemët dhe ekipet e mësuesve kanë mundësinë dhe burimet për të organizuar aktivitete me cilësi të lartë për nxënësit nga shkollat fillore dhe të mesme të përfshira në modelin Nansen për arsimin e integruar ose aktivitete projektesh sipas modelit Nansen

Megjithëse viti 2020 ishte një vit i vështirë për të gjithë ata të përfshirë në procesin arsimor, ku shumë shkolla u desh të riorganizonin funksionimin e përgjithshëm dhe procesin e mësimdhënies, shkollat e përfshira në modelin Nansen për arsim ndërkulturor demonstruan se investimet domethënëse në shkolla si në ndërtimin e kapaciteteve ashtu dhe në infrastrukturë janë të nevojshme dhe të dobishme.

Gjatë vitit 2020, modeli Nansen për arsim ndërkulturor u zbatua në shkollat e mëposhtme:

- ShFK Liria, Tetovë
- ShFK Goce Dellçev, Gostivar
- ShFK Goce Dellçev, Manastir
- ShFK Vëllazërimi Karposh, Shkup
- ShFK Toli Zordumis, Kumanovë
- ShF Penestija, Dibër
- ShF Krste Petkov Misirkov, Radovish
- ShMK Gostivar, Gostivar

Gjatë vitit 2020, modeli Nansen për arsim ndërkulturor u zbatua përmes aktiviteteve të projekteve në shkollat e mëposhtme:

- ShF Goce Dellçev, Konçe
- ShPQSh Georgi Dimitrov, Shkup
- ShFK Nikolla Karev, Krushevë (dhe shkolla rajonale në f. Borinë)
- ShFK Kongresi i Manastirit, Kumanovë
- ShFK Kirili dhe Metodij, f. Kanatllar, Prilep

Aktivitetet e modelit Nansen në shkolla - një urë ndërkulturore midis përmbajtjeve arsimore formale dhe joformale

QDN Shkup vazhdoi të ndihmojë shkollat në çështjet dhe sfidat e funksionimit të tyre të përditshëm të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me vendosjen e vlerave dhe parimeve multikulturore, etosin gjithëpërfshirës të shkollës dhe gjithashtu edhe mbështetjen e aktiviteteve brenda shkollave që ndihmojnë në parandalimin e konflikteve dhe ndarjen e shkollave.

Qëllimi përfundimtar i modelit Nansen për arsim ndërkulturor është sigurimi i qasjes së barabartë në arsimin cilësor të pasuruar me vlera multikulturore dhe gjithëpërfshirëse. Arsimi ndërkulturor u promovua dhe u mbështet përmes qasjes sistematike dhe zbatimit të përbërësve të programit NMIE për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, mësuesit, bashkëpunëtorët e shkollës dhe drejtorët. Aktivitetet e destinuara për nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme u realizuan nga ekipet e mësuesve të trajnuar të cilët punuan në zbatimin e aktiviteteve dy-gjuhësore ndërkulturore jashtëmësimore sipas programeve vjetore për arsimin fillor (klasa e 1. deri në të 9.) dhe arsimi i mesëm (viti i 1. deri në të 4.). Aktivitetet jashtëmësimore ndërkulturore si dhe aktivitetet projektuese Nansen u implementuan në të dy gjuhët, në atë maqedonase dhe shqipe, përkatësisht në gjuhën maqedonase dhe turke duke përdorur metodën e parafrazimit dhe qasjen e lojës gjatë realizimit të pjesëve të ndryshme nga programet vjetore bazuar në grupmosha.

Presidenti Stevo Pendarovski viziton ShF Toli Zordumis, Kumanovë

Më 27 shkurt 2020, presidenti Stevo Pendarovski vizitoi shkollën fillore Toli Zordumis, si një nga shkollat model për arsimin ndërkulturor. Gjatë vizitës së tij, Presidenti, së bashku me nxënësit dhe mësuesit, diskutuan aktivitetet jashtëmësimore të realizuara sipas modelit Nansen. Presidenti kishte mundësinë e drejtpërdrejtë për të parë efektet pozitive të qasjes ndërkulturore në këtë shkollë. Me një kënaqësi të madhe ai u kyç në aktivitetin jashtëmësimore, të udhëhequr nga tandemi i mësueseve Zejnepe Bajrami dhe Merlin Stojanovska, të cilat i janë përkushtuar promovimit të vlerave dhe qëllimeve të Modelit Nansen për shumë vite tani.

Shkollat e modelit Nansen - lehtësuan kalimin në mësimdhënie në distancë falë mbështetjes së vazhdueshme dhe investimeve nga QDN Shkup

Shkollat e përfshira në projektin Modeli Nansen për arsim ndërkulturor kanë përfituar shumë nga zhvillimi profesional i mësuesve gjatë gjithë viteve, d.m.th. nga trajnimi i nivelit bazë dhe të avancuar në kuadër të Qendrës së Trajnimit të QDN Shkup, si dhe programeve të specializuara të trajnimit.

Ashtu si në vitet e mëparshme që nga themelimi i Modelit Nansen për arsim ndërkulturor, QDN Shkup ka siguruar të gjitha burimet dhe udhëzimet e nevojshme për ekipet e mësuesve dhe tandemët e përfshirë në projekt. Shkollat u pajisën me mjete didaktike dhe programe për realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore ndërkulturore. Fatkeqësisht, për shkak të kufizimeve të COVID-19, shkollat fillore dhe të mesme u mbyllën në mars 2020 dhe procesi arsimor u zhvendos në një platformë të mësimit në distancë të krijuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës. Një përjashtim nga kjo ishin nxënësit e shkollës fillore nga klasa e 1. deri në të 3. që u kthyen në shkolla nën protokolle të rrepta dhe në një mjedis shkollor të riorganizuar.

Gjatë gjithë viteve, QDN Shkup ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës së shkollës dhe ka siguruar të gjitha pajisjet e nevojshme për një proces arsimor bashkëkohor. Kjo u tregua të ishte një përfitim i madh për shkollat, së bashku me aftësitë dhe shkathtësitë e zgjeruara të mësuesve për t'u përshtatur me realitetet e reja. Përderisa shkollat tjera kishin vështirësi të siguronin pajisjet e duhura për të kaluar në procesin e të mësuarit në distancë, shkollat Nansen tashmë kishin një infrastrukturë solide TI që e bëri tranzicionin më të lehtë dhe pa kosto shtesë për shkollat dhe komunat. Ky është me të vërtetë një tregues për nevojën e mbështetjes së mëtejshme të shkollave si në mënyrë programore ashtu edhe në përmirësimin e infrastrukturës.

SASHO SHARESKI

Drejtor

ShFK Goce Dellçev, Gostivar

Materialet dhe mjetet didaktike kontribuojnë shumë drejt rritjes së motivimit, ruajtjes së fokusit dhe aktiviteteve thelbësore të mësimdhënies, si dhe zhvillimit të aftësive funksionale midis nxënësve. Përveç sigurimit të materialeve të ndryshme didaktike për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara, miqtë tanë nga QDN Shkup kanë pajisur dhe mobiluar klasat e shkollave tona me video projektorë, sisteme audio, printerë me ngjyra, aparate fotografimi dhe laptopë. Falë këtyre mjeteve teknike, aktivitetet jashtëmësimore dhe procesi i përgjithshëm mësimor fituan një karakter dinamik, multimedial si një komponent thelbësor për të ruajtur interesin dhe vëmendjen e nxënësve.

Është e rëndësishme të theksohet fakti që këto mjete dhe pajisje mbështetëse teknike ishin jashtëzakonisht të dobishme dhe të nevojshme për realizimin e procesit mësimor në distancë për shkak të mbylljes së shkollave gjatë pandemisë COVID-19.

Në emër të të gjithë stafit të shkollës, unë dua të shpreh mirënjohjen time për QDN Shkup, miqtë dhe partnerët tanë të vjetër me të cilët ne zbatojmë me sukses arsimin ndërkulturor, mbështesim zhvillimin profesional dhe kompetencat e kuadrit arsimor si dhe përmirësimin e kushteve të të mësuarit në shkollën tonë.

BERZAT OSMANOSKI

Zëvendës drejtor

ShFK Penestia, Dibër

"Mirënjohja është një tipar i rëndësishëm për çdo person. Askush nuk mund të arrijë larg nëse i harron ata që i kanë dhënë mbështetje kur kjo i duhej"

ShFK Penestia si shkollë me karakter urban në Dibër është përfshirë në mënyrë aktive në projektin Modeli Nansen për arsim ndërkulturor. Shkolla përfitoi shumë nga programi trajnues i QDN Shkup për mësimdhënës të cilin e kanë përfunduar me sukses 46 mësues nga shkolla jonë.

Falë QDN Shkup, ne kemi klasa të pajisura plotësisht me të gjitha pajisjet thelbësore dhe më bashkëkohore të TI-së, si dhe të gjitha sistemet e nevojshme operative. Ekipi i QDN Shkup në vazhdimësi ua siguron ekipeve tona të mësuesve të gjitha materialet e nevojshme mbështetëse për zbatimin e aktiviteteve jashtëmësimore si dhe procesin e rregullt të mësimdhënies, si p.sh: literaturë profesionale, letërsi për fëmijë, lojëra të ndryshme shoqërore, lodra etj. Falë këtyre mjeteve didaktike, mësuesit organizojnë aktivitete me cilësi të lartë si në procesin e rregullt të mësimdhënies ashtu edhe aktivitete jashtëmësimore ku nxënësit kënaqen plotësisht.

Falë projektit Nansen, shkolla mori pajisje TI dhe shumë mjete dhe materiale didaktike të dobishme. Ky ishte një investim shumë i vlefshëm duke pasur parasysh që stafi mësimor dhe administrata e shkollës përballen me sfida të reja në lidhje me pajisjen e stafit të shkollës me pajisje të TI-së. Falë pajisjeve në fjalë, stafi mësimor i realizoi përmbajtjet mësimore shumë më lehtë.

"Miqtë mbështesin njëri-tjetrin në kohë të vështira" kjo u demonstrua nga QDN Shkup në shumë raste, pasi donacioni i bërë në fillim të pandemisë ku 15 pako me dezinfektues u dorëzuan në shkollë nga QDN Shkup. Dezinfektuesit kishin një rëndësi të madhe për shkollën, ku në këto kushte të veçanta në një pandemi çdo mbështetje dhe ndihmë është e paçmuar.

MARINA HADZIPANZOVA
Pedagoge
ShFK Vëllazërimi, Shkup

Si pedagog profesional në shkollën fillore komunale Vëllazërimi - Shkup, është një kënaqësi e madhe për mua të shpreh pikëpamjet e mia në lidhje me burimet, materialet didaktike dhe pajisjet e TI të siguruara nga QDN Shkup në vitin akademik 2020/2021.

Duke pasur parasysh që pandemia shkaktoi çrregullim të dinamikës në veprimtarinë tonë shkollore, aktivitetet jashtëmësimore për arsimin ndërkulturor nuk mund të realizoheshin plotësisht. Është vërejtur se nxënësve u mungonin aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore me mësuesit e tyre tandem.

Për sa i përket procesit arsimor, pandemia COVID-19 shkaktoi probleme teknike për mësuesit dhe u vu re se mësimi në distancë ishte pjesërisht efektiv si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Ne gjithashtu kemi vërejtur një numër të shtuar të nxënësve të cilët kanë vështirësi në përvetësimin e materialit mësimor. Dua të nënvizoj se vështirësitë më të theksuara të mësimit në distancë janë se zvogëlohet efektiviteti i punës së mësuesve dhe se materialet digjitale nuk u ndihmonin shumë nxënësve në mënyrë që ata të zotëronin me sukses përmbajtjen arsimore.

Përvoja e deritanishme ka treguar se gjatë pandemisë, aplikimi i materialit didaktik dhe pajisjeve të TI-së të dhuruara nga QDN Shkup u mundësoi mësuesve që të organizojnë dhe zbatojnë me sukses përmbajtjen mësimore me prani fizike, për shkak të faktit se burimet e siguruara mundësuan që secili mësues lehtësisht të përdorë ato për zbatimin e TIK dhe përmbajtjeve elektronike në mësimdhënie.

PUBLIKIME

Promovimi i doracakut "101 lojëra"

Qendra për Dialog Nansen Shkup promovoi doracakun "101 lojëra" të krijuar dhe përgatitur nga ekipi i QDN Shkup. Ai përmban një mori lojërash të lehta dhe interesante për të gjitha moshat. Lojërat e ofruara janë të shumëllojshme dhe të zbatueshme si në shkollë ashtu edhe në ambiente shtëpie / familjare.

Doracaku është menduar për të gjithë mësuesit, arsimtarët, bashkëpunëtorët profesionalë, prindërit, nxënësit dhe të gjithë profilet e tjerë të interesuar.

Ky burim i vlefshëm prej 101 lojërash do të ndihmojë në promovimin e lojërave si një pjesë e rëndësishme dhe stimuluese në procesin arsimor.

Doracaku "101 lojëra" është në dispozicion në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke.



Promovimi i librit të bashkëbisedimeve Maqedonisht-Shqip/Shqip-Maqedonisht

Në përpjekjet e saj për të përmbushur vizionin si një organizatë joqeveritare që promovon arsim më të mirë të bazuar në ndërkulturalizëm dhe kohezion ndëretnik, Qendra për Dialog Nansen Shkup përpiloi librin e bashkëbisedimeve maqedonisht-shqip/shqip-maqedonisht, një projekt i mbështetur nga Komisariati i Lartë për Pakicat Kombëtare pranë OSBE-së, i cili është përgatitur nga dy autorë, profesorë universitar, Dr. Berton Sulejmani dhe Dr. Veselinka Labroska.

Libri i bashkëbisedimeve gjendet jo vetëm në formë të botimit klasik të shtypur, por edhe në version elektronik në dispozicion falas në një faqe të internetit të dizajnuar nga Vane Rujkov, dhe si një aplikacion i caktuar elektronik, ku dialogët mund të dëgjohen nga folës të përshtatshëm të një gjuhe të caktuar. Libri i bashkëbisedimeve është në dispozicion në faqen e internetit në vijim: www.fraza.mk. Për më tepër, libri i bashkëbisedimeve mund të shkarkohet falas në një telefon celular - Android nga Play Store dhe iOS nga App Store.

Libri i bashkëbisedimeve përbëhet nga pjesët vijuese: Parathënie, Përmbajtje, Fjalë kyçe ku jepen këto përmbajtje: Numrat, Përshëndetjet, Shprehjet e mirësjelljes, Ditët e javës, Muajt e vitit, Emrat e qyteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Emrat e qyteteve më të mëdha në rajonin më të afërt, Emrat e shteteve, Festat, Frazeologjia Shqip-Maqedonisht, Frazeologjia Maqedonisht-Shqip dhe më pas, pjesa qendrore e librit përmban gjithsej 42 Dialogë, që përshkruajnë situata të ndryshme nga jeta e përditshme e një grupi nxënësish të shkollave të mesme (pjesët e titujve të dialogëve janë si më poshtë: Në taksi, Në stacionin e trenit, Në tren, Në kioskë, Me autobusin e qytetit, Në gjimnaz, Në postë, Rrugës për në aeroport, Informacione, Takim me njerëz, Në kampin veror, Në zyrën e regjistrimit, Tek këpucari, Në restorant, Në treg, Jashtë për shëtitje, Udhëtim me varkë, etj.).





Dialogët zhvillohen nga personazhe specifike dhe pasqyrojnë shqiptimin e mirëfilltë standard në të dy gjuhët, por me fjalor bisedor kudo që ka nevojë që dialogu të tingëllojë më natyrshëm. Pas çdo dialogu ka një fjalor të shkurtër me fjalë/shprehje nga tema e dhënë në dialog, si dhe një përmbajtje e shkurtër gramatikore për një fjalë të zgjedhur nga dialogu specifik (formë foljore, emër, mbiemër, përemër, lidhëz, parafjalë, nyje, etj.), e gjithë kjo e hartuar dhe e përgatitur bukur nga autorët, Sulejmani dhe Labroska. Si mënyrë për të pasuruar njohuritë, në fund të secilit dialog ka një fjalë të urtë, zakonisht identike në kuptim dhe në përbërjen e fjalëve në të dy gjuhët, maqedonase dhe shqipe. Dialogët janë të pasuruar me përmbajtje që ofron të dhëna interesante gjeografike dhe historike për vendet e personazheve nga libri i bashkëbisedimeve.

Me ndihmën e këtij libri bashkëbisedimesh për mësimin e gjuhës maqedonase / shqipe, i pari i këtij lloji në mjedisin tonë, kushdo që dëshiron të mësojë thjesht duke dëgjuar shqiptimin, por edhe me mundësinë e njëkohshme për të ndjekur shkrimin e saktë të fjalisë së dhënë, tani mund ta bëjë atë më shpejt dhe më lehtë, me disa klikime në aplikacionin e librit të bashkëbisedimeve www.fraza.mk ose duke përdorur versionin e tij të shtypur.

Me këtë libër të bashkëbisedimeve, Qendra për Dialog Nansen Shkup dhe Komisariati i Lartë për Pakicat Kombëtare pranë OSBE-së kanë mundësuar realizimin e një projekti domethënës për një komunikim më të mirë në këtë pjesë të Ballkanit, përmes realizimit të vlerave të shumëgjuhësisë, krijimtarisë dhe origjinalitetit. Ky libër bashkëbisedimesh, si dhe Fjalori i dyanshëm botuar më parë maqedonisht-shqip/shqip-maqedonisht (në dispozicion në www.hcnm-ndc.org), përfaqësojnë një hap tjetër përpara në drejtim të mirëkuptimit dhe kohezionit më të mirë ndëretnik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Publikimi i raportit të vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i Qendrës së Dialogut Nansen Shkup u organizua dhe u realizua në tremujorin e fundit të vitit 2019, duke u përqendruar në kriteret në vijim: rëndësia, efektiviteti, efikasiteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria.

Vlerësimi i jashtëm, i porositur nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, rishikoi dhe pasqyroi aktivitetet e programit QDN Shkup nga viti 2008 deri në vitin 2019, duke marrë parasysh të gjitha politikat e zbatueshme, strategjitë, dokumentacionin e përgjithshëm të programit dhe vizitat në terren.

Vlerësimi i kryer konfirmoi qartë dhe saktë rëndësinë e aktiviteteve programore të QDN Shkup për kontekstin aktual shoqëror, si dhe harmonizimin e tyre me përparësitë strategjike të vendit në fushën e arsimit, por gjithashtu edhe në lidhje me kohezionin e dëshiruar shoqëror dhe nevojat e shkollave.

Raporti i vlerësimit është një tjetër mbështetje e fortë dhe konfirmim i domosdoshmërisë së të gjitha përpjekjeve të QDN Shkup në ndërtimin e një ambienti ndërkulturor në institucionet arsimore.

Donatori kryesor i Qendrës për Dialog Nansen Shkup
është Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë